

# Dukagjini "Nderi i Kombit"



# Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XVII i botimit, nr. 195, Janar 2020  
Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355674001940, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktore: Suela Ndoja, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

## SHPIRTI ARTISTIK DUKAGJINAS PËRFAQËSON TRI HERË SHQIPËRINË NË EUROVIZION 5

### TRUMFON ARILENA ARA NË FEST 58 TRSH

Arikena Ara është kurorëzuar me çmimin e parë me këngën 'Shaj', me muzikë të Darko Dimitrov e Lazar Cvetkovski dhe tekst të Lindon Berishës, i njëjti autor i hitit të saj "Nëntori". Në vazhdimsinë e sukseseve të saj trumfon në festivalin e 58 të këngës në RTSH. Jo vetëm një herë gjatë natës së fundit, publiku ka thirrur emrin e saj duke u ngritur më këmbë, ashtu si edhe në momentin kur u shpall fituese, spektatorët shpërthyen në thirrje e duartrokitje. Ajo dhe vetëm ajo arrit të dëpërtoj në shpirtin artdashës të Shqiptarëve. Ajo nuk e luajti këngën ajo e perjetoi për vetë dhe për të tjerët, Këto emocione jemi mësuar të na i dhuroj Arikena.



## NË SOFRËN E DUKAGJINIT NË NEW- JORK U SHPALOSËN VLERAT MË TË MIRA TË FOLKLORIT DUKAGJINAS 7

Trashëgimia kulturore e Dukagjinit po pasurohet nga viti në vit me krijimet dhe interpretimet e reja në veprimtaritë e ndryshme që zhvillohen kudo ku ka shqiptarë e në veçanti ku ka dukagjinas. Më të dendura këto veprimtari zhvillohen në çdo fund viti, duke e pasuruar si në sasi e cilësi trashëgiminë kulturore-artistike. Nuk ka rëndësi çfarë emri i vënë veprimtarisë: sofër, tërvesë apo nata të ndryshme tradicionale, rëndësi ka që ato të zhvillohen kudo në botë ku ka dukagjinas dhe të kenë sa më shumë krijimtari të reja. Është për tu përgëzuar dhe entuziazmuar, sepse kudo ku ka dukagjinas, edhe pse të larguar nga vendlindja, mbartin me vete atdhedashurinë, vetitë e virtytet më të mira të trashëguara që i qëndrojnë kohës dhe bëjnë përpjekje për të mbajtur gjallë vlerat më të mira kulturore e artistike duke e pasuruar ato.



# REALIZIMET E VITIT 2019, NJË BAZË E MIRË PËR TË VIJUAR REALIZIMIN E MISIONIT TË SHOQATËS, NË VITIN 2020

A nëtar të shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, dukagjinase dhe simpatizantë të tyre, në vitin 2019, jo pak realizime janë bërë, të cilat nderojnë ne dhe gjithë bashkësinë dukagjinase kudo ndodhur! Këto realizime janë:

*Së pari*, me punën e palodhur të anëtarëve e anëtarëve të redaksisë, më në krye zonzushën Suela Ndoja, dhe të simpatizantëve të tyre, gazeta “Dukagjini” ka dalë rregullisht në çdo muaj. Numri i saj ka mbërritur 195, në saj dhe të kontributit financiar të Anton Kosterit, Mark Maracaj, Vilson Peshkaj e Mikel Kopsaj, Fran Fushes e Prele Kroj, Pëllumb Shqau, Donika e Agim Martini, Lulash Gjeloši, Kolë Çardaku e Pal Shkëmbi, Kole Çardaku, Agim Dardha, Alfred Bari e Pjeter Gjeta, me shumën e përgjithshëm 246 000 leke. I falënderojmë me shprehjen popullore: “Paçin e dhënçin!”

*Së dyti*, kemi marrë pjesë duke qënë edhe organizator, në disa veprimtari:

- Me ftesë të drejtorit të shkollës së mesme profesionale “Skënderbeu”, në Kaçanik, morëm pjesë në kuadrin e 50 vjetorit të themelimit të saj, një përfaqësi e shoqatës, Ndue Sanaj, Zef Bari, Tringa Rapi, .... e Anton Kosteri. Me këtë rast nderoi dëshmorët e kësaj shkolle, me titullin “Mehmet Shpendi”, profesorin Nevzat M. Çallaku dhe nxënësen Emsale Z. Frangu, me motivacionin: “Për heroizëm të jashtëzakonshëm në mbrojtje të Atdheut, duke u flijuar për të mbetur të përjetshëm në kujtesën e brezave”. Nderojë Gjymnazin “Skënderbeu” në Kaçanik, me titullin “Mirënjohja Martin Camaj”, me motivacionin: “Një ndër shkollat e vjetra të shkollimit të mesëm shqip, e shquar për suksese, për rezistencë kombëtare dhe për përgatitjen e personaliteteve në të gjitha fushat e jetës shoqërore e të shkencës”. Për realizimin e kësaj pjesëmarrje kontribuoi Anton Kosteri, Zef Bari e Tringa Rapi.

- Në kuadrin e 7-8 marsit, me datën 5 mars 2019, në mjediset e Bar-Restorant “Orlando” zhvilloi takimin me mësues e mësuese dhe me disa gra e nëna dukagjinase. Me këtë rast u nderuan me titullin “Mirënjohja e shoqatës atdhetare Dukagjini”, mësueset e mësuesit: Familja Gjokë Pjeter Marku, familje arsimtarësh, e cila me rastin e Konferencës shkencore për shkollimin e 100 viteve, në Dukagjin, i është propozuar Presidentit të Republikës për dekorim; Gjok Verrishta, Jak Sharani, Drande Kole Odri, Leke Pjetri, Gjyste Lera, Gjergj Shytani, Prenda Sogja, Simon Zhuri, Violeta Plepi, Lazer Filipi, Lule Ahi dhe Muç Marku.

Gjithashtu u nderuan me këtë titull disa gra dukagjinase: Age Gila, Tone Pal Çuni, Age Tome Rroku, Shaqe Ndoja, Violeta Verrishta, Sose Bari, Prenda Dede Cardaku, Dukate Bregu, Moter Dukate Radoja, Lule Gjon Molla, Moter Leze Preka, pas vdekjes, Katrina Fusha, Leze Bungaja, Drande Dema, Lula Ndoja, Mri

Vogel Pjetri. Ndërsa N/Kolonele Tringa Rapi, është nderuar me titullin “Nderi i Shoqatës Atdhetare Dukagjini” dhe Gerta Bardeli është nderuar me titullin “Anëtare Nderi e Shoqatës Atdhetare Dukagjini”

Për këtë veprimtari punoi Roza Pjetri, Luigj Shyti, Elida Delija, Age Martini e Prele Shytani, të cilët i falënderojmë për ndihmësen që dhanë në organizimin, në përgatitjen dhe zhvillimin e saj. Për përgatitjen e zhvillimin e kësaj veprimtarie ndihmuan financiarisht: Pronari i Bar-



Restorant “Orlando”, Tom Arra, i cili na siguroi sallën, foninë dhe një koktej të mirë; Edmond Tërthorja, administrator i Universitetit Bujqësor në Kamzë; Gjergj Leqejza, konsulli i Nderit i republikës së Austrisë në Shkodër dhe N/Kryetari i Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”; Shkrimtari Ndrek Guri dhe avokati Tonin Marku. Të gjithë, në emrin e shoqatës i falënderojmë dhe ju urojmë, me shprehjen popullore: “Paçin e dhënçin!”

- Me 31 Marsit në sallën “Kardinal Mikel Koliqi”, në një atmosferë të ngrohtë pranverore u promovua libri “Dukagjini ynë - IV, klerikë të shquar” të autorëve Prelë Milani dhe Lazer Kodra, të dy ambasador të ruajtjes dhe përcjelljes me mjeshtëri të vlerave dukagjinase. I pranishëm në këtë veprimtari ishte Monsinjor Massafra. Gjithashtu e pranishme ishte kryetarja e Këshillit të Qarkut Shkodër, zj. Greta Bardeli. Shumë dhanë opinionet e tyre për këtë libër me vlera të veçanta, në veçanti për brezin e ardhshëm, për tu njohur me klerikët dukagjinase dhe me sakrificat e tyre në shërbim të Zotit e atdheut, si Suela Ndoja, Luigj Shyti, Ndue Sanaj, Mimoza Rexhelaj, Kadri Fikaj, Fric Fistani, Ilmi Kurti e të tjerë. Përhëndeti Monsinjor Angelo Massafra.

Zonja Gerta Bardeli, pasi përshëndeti, ajo njoftoi, se me propozim të Kryesisë së Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, Këshilli i Qarkut Shkodër ka nderuar me titullin

“Nderi i Qarkut Shkodër”, zotërinjtë Gjergj Leqejza e Luigj Mila.

Z. Gjergj Leqejza, konsulli i Nderit të republikës së Austrisë në Shkodër dhe n/Kryetari i Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, i dorëzohet titulli “Nderi i Qarkut Shkodër” me motivacionin “Në shenjë nderimi për kontributet në fushën e shoqërisë civile. Mbështetës të veprimtarive me ndikim në zhvillimin social e kulturor të qarkut Shkodër”;

Z. Luigj Mila, kryetari i Komisionit

Në këtë festë morëm pjesë, me një grup të nxënësve të shkollës 9 vjeçare “Dede Gjon Luli”, në Hot të Ri: Paula Pllumbaj, Denilsona Rrasa, Xhesika Zefi, Pamela Mirashi, Xhovana Bashota, Gjesika Mirashi, Dorjan Rrasa, Valentin Prela e Emanuel Lungaja. Ne perberje te gripit ishin krye Drejtpori i shkollës, zotin Gjovalin Kodra, mësuesen e edukimit, zonzjën Drita Zefi dhe mësuesja Marije Buxha. Gjithashtu morën pjesë dhe miqtë e vjetër të kësaj shoqate, zoti Aleks Dushi, Prele Shytani e Kole Çardaku, Roza Pjetri e Lulash Brigja. Me këta nxënës u paraqitem me vallen e “Mrizit”; me dy recitime: Dorian Rrasa me poezinë e “Kosova” dhe Pamela Mirashi, me poezinë “Gjuha Shqipe”; dhe me një ekspozitë, me 13 punime piktore, të piktori të vogël, të klasës së tetë, Emanuel Lungaja. Gjithashtu një prezantim shumë të mirë bëri dhe rapsodi Gjon Kosteri, me lahutë, me këngën e madhe, të titulluar “Lahuta Iliriane”.

Me këtë rast, Shoqatës “Martin Dreshaj”, në emër të kryesisë së Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, ju dhurua një panoramë në allci “Shkodra”, të cilën e dorëzoi Aleks Dushi, ai që ka bërë të mundur ndërmjetësimin me këtë shoqate. Pastaj u ndanë disa tituj nderi nga kryesia e shoqatës “Maryin Dreshaj”. Shoqatës sonë, ju dha titulli “Mirënjohja e Shoqatës Martin Dreshaj”, për pjesëmarrjen e mbështetjen, që i kemi dhënë veprimtarive të saj”. Zotit Sokol Cubi, ju dha titulli “Anëtari Nderi i Shoqatës Martin Dreshaj”. Shkollës 9 vjeçare “Dede Gjon Luli, ju dha titulli “Mirënjohja e shoqatës Martin Dreshaj”, Publicistit e poetit Lualsh Brigja, ju dha titulli “Mirënjohja e shoqatës Martin Dreshaj”; Rapsodit Gjon Kosteri, ju dha titulli “Mirënjohja e shoqatës Martin Dreshaj”. Mundësuan pjesëmarrjen, në këtë veprimtari: zoti Sokol Cubi, zoti Mhill Prroni e zoti Agron Hasanaj. - Me ftese të Komisionit për Drejtësi e Paqe, morëm pjesë në përkujtim të viktimave të komunizmit, me datën 20-22 maj 2019.

Me 20 Maj 2019, u bë përirimi i memorialit të qëndresës, kushtuar të Persekutuarëve Politik nën regjimin komunist, kompozuar e ndërtuar nga skulptori



Kruja. Qindra të pranishëm në këtë eveniment, përballë Bashkisë Shkodër, duke përfshirë edhe personalitete të fushave të ndryshme, përjetuan çaste që flisnin më shumë se qindra faqe libri.

Me datën 21 Maj 2019 dhjetëra të persekutuar dhe të tjerë u nisën në orën 8.00 të mëngjesit drejt ish kampit të burgut Spaçit të Mirditës.

Me datën 22 Maj 2019, morëm pjesë në përkujtimoren e revoltës të burgosurve të Qafës së Barit, që u zhvillua me 22 maj 1984 dhe tronditi diktaturën komuniste.

Mundësuan ketë pjesëmarrje, Luigj Mila, Sekretari i Komisionit për Drejtësi e Paqe.

- Me 19 qershor 2019, në mjesditet e Qendrës Rinore "Arka", në Shkodër u organizua ceremonia e dekorimit të bashkëpunëtorit e mikut tonë, Gjergj Leqejza-konsull i Republikës së Austrisë për verin e Shqipërisë, me qendër në Shkodër.

- Me datën 30 Maj 2019, morëm pjesë në veprimtarinë e përgatitur dhe e zhvilluar nga shkolla 9 vjeçare-Bardhaj, me temë "Dhuro dashuri e përkujdesje", një veprimtari sensibilizuese në kuadër të ditës ndërkombëtare të familjes.

- Me datën 22 tetor 2019, morëm pjesë në festën Kombëtare të Republikës së Austrisë. Ceremonia, e organizuar nga Konsulli i Nderit në Shkodër, i Republikës së Austrisë, zoti Gjergj Leqejza bashkë me të ngarkuarin me punë të Ambasadës së republikës së Austrisë, zotin Christian Steiner në Tiranë.

- Me 26 tetor 2019, me ftesë të organizatoreve të veprimtarisë së VI të Ditës së Plisit, morëm pjesë, një grup prej tre vetash, anëtar të shoqatës atdhetare "Dukagjini", me rapsodët Kol Aramadi dhe Gjon Kosteri.

Me këtë rast, u nderuan katër kullat të trevës së Skënderajve, në Prekaz, me titullin "Mehmet Shpendi": Kompleksi Memorial "Adem Jashari", me motivacion: "Adem Jashari simbol i rezistencës, luftës dhe lirisë për bashkimin nacional. Akti i tij heroik pasuron fletët e historisë tonë të lavdishme. Prekazi për jetë rrezaton rreze lirie, këtu u shkrua me shkronja të arta historia më e re e nacionalitetit shqiptarë"

*Kulla e Heroit Ilaz Kodra - "Kulla e Bashkimit"*, me motivacion: Top of Form-Bottom of Form "Kulla e bashkimit, dijes dhe e pushkës, çerdhe e UÇK-së. Në këtë tempull u morën vendime të rëndësishme për nacionalitetin tonë. Kulla, që e ngriti vetëdijen tonë për liri e bashkim nacional" *Kulla Muze e Tahir Mehes*, me motivacion: "Për rezistencën ndaj pushtuesit serb, Kullë muze ku ruhet trashëgimia shpirtërore, materiale e luftarake e popullit shqiptar"

*Kulla e Ahmet Delisë*, me motivacion: "Për trimëri e solidaritet ndaj popullit të vet. Kullë që e ngrit moralin e krenarin për të kaluarën dhe të ardhmen ndër breza"

Mundësuan pjesëmarrjen në ketë veprimtari Nikolin Shqau, Gjergj Leqejza e Anton Kosteri.

- Me 16 nëntor 2019 morëm pjesë në përrimin e kishës 800 vjeçare apo kishën e Shën Premtes, në Balldre të Lezhës, të organizuar nga Dioqeza e Lezhës, Instituti Arkeologjik, Konsullata e Nderit e Austrisë dhe Bashkia e Lezhës. Mundësuan pjesëmarrjen në ketë veprimtari Agron

Hasanaj.

Të gjitha këto veprimtari janë mundësuar nga Zef Bari, Vilson Peshkaj, Mark Maraçaj, Pëllumb e Nikolin Shqau, Sokol Cubi, Mri e Prele Kroj, Kolë Çardaku, Gjergj Leqejza, Mhill Prroni, Lulash Gjeloshi, Anton Kosteri, Agron Hasanaj, Tonin Marku, Edmond Terthorja, Mikel Kopsaj, Agim Martini, Fran Fusha, Pal Shkambi, Agim Dardha, Alfred Bari e Pjeter Gjeta. Gjithsejtë 356 950 leke.

Të gjithë i falënderojmë për kontributin e tyre, në realizimin e misionit të shoqatës! Paçin e dhënçin!

\*\*\*

Mbi bazën e këtyre arritjeve, Kryesia e Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", për vitin 2020 ka planifikuar këto veprimtari:

1-Njerrjen e gazetës "Dukagjini", në çdo muaj, me 16 faqe dhe me 300 kopje,

(Sokol) Shpendi. Në këtë kuadër, të përgatisim e zhvillojmë një Konferencë Përkujtimore, në me 12 korrik 2020 dhe me datën 15 korrik te shkojmë ne Qeresh e pastaj, me datën 16 korrik te vendosim kurora pranë monumentit te Mehmet Shpendit.

Prele Milani e Vilson Peshkaj (Seksioni i historisë)

6- Ndryshe nga çdo vit tjetër, vitin e ardhshëm, me rastin e 95 vjetorit të lindjes së albanologut Martin Camaj, me 25 korrik 2020 do të përfundojë rindërtimi i monumentit të tij, dhe promovimi i tij së bashku me botimin e materialeve të konferencës shkencor kushtuar veprës së tij albanologjike.

#### Kryesia e Shoqatës

7- Përmbyllja e veprimtarisë VII "Dita e Plisit" do të zhvillohet në Kështjellën "Rozafa", në muajin tetor 2020, me



që po të thuash jepet falas.

Redaksia e gazetës

2-Një konferencë shkencore, kushtuar "Mbi punën që duhet bërë për tu shmanhur nga kultivimi i drogës në zonën e Dukagjinit", muajin shkurt (datë 22, ditë e shtune) 2020.

#### Prele Milani e dr. Ndue Nika

3- Një takim me nxënësit më të mire dukagjinas, me rastin e 7 marsit, me datën 2 ose 3 mars 2020.

Arbër Shytani, Lazer Kodra e Dukate Bregu

4- Marrja pjesë në gjitha ftesat e shoqatave analoge, veçanti në Manifestimin "Zëri i Vëllazërisë-2019", që organizohet nga Shoqata "Martin Dreshaj", me qendër në Pejë, në muajin Prill 2020.

#### Kryesia e Shoqatës

5- Veprimtari përkujtimore, të 110 vjetorit të Luftës së Qafës së Agrit, me datën 10 korrik 2020; 105 vjetori i Qëndresës së Dukagjinit, në Plan, kundër Forcave të Armatosura të Malit të Zi, me 15 korrik 2020 dhe të rënies së atdhetarit Mehmet

pjesëmarrjen e përfaqësuesve të të gjitha hapësirave shqiptare, që mbajnë kësulën e bardhë. Sigurisht, për përgatitjen e kësaj veprimtarie, do të kemi mbështetjen e Bashkisë e Qarkut Shkodër, të drejtorisë së Monumente të kulturës e të Muzeut Historik të Shkodrës, por ne do të jemi drejtuesi i saj. Në këtë veprimtari mund të marrin pjesë rreth 200 vete, të cilëve duhet tu jepet së paku një drekë dhe do të shpërndajmë disa tituj nderi. Kjo veprimtari te zhvillohet me datën 24 tetor 2020

#### Kryesia e Shoqatës

8- Gjate vitit mund të kemi veprimtari përkujtimore, të paraqitjes së librit dhe në pjesëmarrës në veprimtari të tjera të ftuar nga shoqata analoge.

#### Kryesia e Shoqatës

Përgatitja e zhvillimi i këtyre veprimtarive, ka dhe një kosto financiare, si më poshtë:

1-Njerrjen e gazetës "Dukagjini", në çdo muaj, me 16 faqe dhe me 300 kopje, që po të thuash jepet falas. Një botim i kësaj gazete në muaj kushton 20 500 leke

x 12 muaj = 246 000 lekë në vit.

2-Një konferencë shkencore, kushtuar "Mbi punën që duhet bërë për tu shmanhur nga kultivimi i drogës në zonën e Dukagjinit", muajin shkurt (datë 22, ditë e shtune) 2020, e cila na kushton rreth 50 000 lekë;

3- Një takim me nxënësit më të mire dukagjinas, me rastin e 7 marsit, me datën 2 ose 3 mars 2020. i cili na kushton rreth 52 000 lekë.

4- Marrja pjesë në gjitha ftesat e shoqatave analoge, veçanti në Manifestimin "Zëri i Vëllazërisë-2019", që organizohet nga Shoqata "Martin Dreshaj", me qendër në Pejë, në muajin Prill 2020, e cila na kushton rreth 95 000 lekë.

5- Veprimtari përkujtimore, të 110 vjetorit të Luftës së Qafës së Agrit, me datën 10 korrik 2020; 105 vjetori i Qëndresës së Dukagjinit, në Plan, kundër Forcave të Armatosura të Malit të Zi, me 15 korrik 2020 dhe të rënies së atdhetarit Mehmet (Sokol) Shpendi. Në këtë kuadër, të përgatisim e zhvillojmë një Konferencë Përkujtimore, në me 12 korrik 2020 dhe me datën 15 korrik te shkojmë ne Qeresh e pastaj, me datën 16 korrik te vendosim kurora pranë monumentit te Mehmet Shpendit, e cila na kushton afërsisht rreth 75 000 lekë

6- Ndryshe nga çdo vit tjetër, vitin e ardhshëm, me rastin e 95 vjetorit të lindjes së albanologut Martin Camaj, me 25 korrik 2020 do të përfundojë rindërtimi i monumentit të tij, dhe promovimi i tij së bashku me botimin e materialeve të konferencës shkencor kushtuar veprës së tij albanologjike, e cila na kushton rreth 7 000 euro, 861 000 lekë.

7- Përmbyllja e veprimtarisë VII "Dita e Plisit" do të zhvillohet në Kështjellën "Rozafa", në muajin tetor 2020, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të të gjitha hapësirave shqiptare, që mbajnë kësulën e bardhë. Sigurisht, për përgatitjen e kësaj veprimtarie, do të kemi mbështetjen e Bashkisë e Qarkut Shkodër, të drejtorisë së Monumente të kulturës e të Muzeut Historik të Shkodrës, por ne do të jemi drejtuesi i saj. Në këtë veprimtari mund të marrin pjesë rreth 200 vete, të cilëve duhet tu jepet së paku një drekë dhe do të shpërndajmë disa tituj nderi. Kjo veprimtari te zhvillohet me datën 24 tetor 2020, e cila mund të na kushtoi rreth 500 000 lekë

8- Gjate vitit mund të kemi veprimtari përkujtimore, të paraqitjes së librit dhe në pjesëmarrës në veprimtari të tjera të ftuar nga shoqata analoge, për të cilat duhet të llogarisim rreth 335 700 leke.

Gjithsejtë na duhen rreth 2 214 700 lekë

\*\*\*

Për të realizuar ketë plan të veprimtarive të shoqatës gjate vitit 2020, duhet kontributi i të gjithëve.

Së pari, kontributi intelektualëve dukagjinas, me ide e pjesëmarrje të tyre.

Së dyti, kontributi i biznesmenëve dukagjinas, se pa kontributin e tyre financiar nuk mund të përgatitën e realizohen këto veprimtari.

Besojmë në kontributin tuaj!

**NDUE SANAJ**

Kryetari i shoqatës atdhetare "Dukagjini"

# DITA BOTËRORE E PAQES

8 Janar 2020

Data 1 Janar e çdo viti shënon fillimin e vitit të ri në gjithë botën, por për besimtarët katolike është një ditë ripërtëritjeje shpirtërore ngaqë me 1 Janar të çdo viti, duke filluar nga viti 1968 me Papa Palin VI, bëhet publik mesazhi i Shenjtërisë së Tij drejtuar besimtareve katolikë në gjithë botën por edhe atyre të besimeve të tjera. Viti 2020 përkon me vitin e LIII të ditës botërore të paqes dhe në Shqipëri me vitin e XXIII që nga fillimi i krenimit të kësaj dite, e cila e ka zanafillën e saj në vitin 1997.

U iniciua nga fretërit françeskane dhe nga viti 2003 organizimi dhe vazhdimi i kësaj tradite iu besua Komisionit Drejtësi dhe Paqe të Shqipërisë i cili në bashkëpunim me Arqipeshkvinë Shkodër – Pult dhe nën kujdesin e veçantë të Arqipeshkvit, Imzot Angelo Massafra, e ngriti nivelin e saj duke i dhënë rëndësinë e merituar dhe duke e zhvilluar atë në teatrin Migjeni të Shkodrës.

Si çdo vit ishin të pranishëm shumë qytetarë të Shkodrës, përfaqësues të komuniteteve fetare ku mund të përmendim Imzot Angelo Massafra, Arqipeshkvë Mitropolit i Shkodër-Pult; Ipeshkvi i Sapës Imzot Simon Kulli; At' Nikolla Petani, famullitari i Kishës Autoqefale Ortodoksë në Shkodër, gjithashtu edhe përfaqësues të jetës politike të qytetit ku mund të përmendim kryetaren e bashkisë Z. Voltana Ademi.

Mesazhi i Shenjtërisë së tij, Papa Françesku, për këtë vit ishte: Paqja si ecje shprese: dialog, pajtim dhe kthim ekologjik.

Një temë shumë aktuale, e përbërë nga disa nën tema, në thelb të të cilave

është gjithmonë paqja, sepse siç thotë Papa: Paqja është një pasuri e çmuar, objekt i shpresës sonë, për të cilën aspiron gjithë njerëzimi!

Pikërisht për të arritur paqen duhet të jetojmë në harmoni me të afërmit, nevojtarët, popujt e tjerë por edhe me natyrën. Problemet ambientale janë një temë e prekur edhe nga Papa Françesku.

Duhet të vlerësojmë zemërgjerësinë e

Krijuesit që na dhuroi tokën, thotë Papa.

Duke parë gjendjen e rënduar të planetit tonë, për të cilën të gjithë jemi dëshmitarë, kësaj teme iu kushtua më shumë vëmendje. Për këtë arsye, koncerti festiv i përvitshëm me rastin e Ditës Botërore të Paqes, u hap me një video sensibilizuese për problematikat me të cilat po përballet planeti ynë sot.

Si gjithmonë, kishte një ndërthurje të mesazhit të Shenjtërisë së tij me një aktivitet artistiko – kulturor me të rinj të qytetit të Shkodrës dhe të famullive përreth. Kjo ditë është një feste dhe për këtë arsye u shoqëruar nga këngë dhe valle nga të rinjtë, por gjithashtu është edhe një ditë sensibilizimi për detyrat tona si qenie njerëzore ndaj njëri – tjetrit por edhe ndaj natyrës.

Shqipëria, në nëntorin e vitit 2019, përjetoi një tragjedi njerëzore dhe shqiptarët ishin dëshmitarë të forcës së natyrës. 26 nëntori ishte dita kur 51 njerëz humbën jetën në tërmetin e rënë, të cilat u kujtuuan edhe në aktivitetin e organizuar me 2 poezi kushtuar atyre.

Kjo ngjarje duhet të na ndërgjegjësojë dhe të na mësojë të respektojmë më shumë natyrën dhe forcën e saj krijuese por nganjëherë edhe shkatërrimtare.

Veprimtaria u mbyll me mesazhin e përfaqësuesve shpirtëror dhe administrativë drejtuar të pranishmëve dhe gjithë shqiptarëve në mbarë botën, duke i uruar atyre VIT TË MBARË!

**Majk Mila,**  
Shkodër, 15 janar 2020



# DRISHTI NGA ANTIKITETI NË MESJETË

Me datë 16 Dhjetor 2019, në mjediset e Muzeut Dioqezan - Shkodër, Komisioni Drejtësi dhe Paqe i Shqipërisë, në kuadër të forcimit të rolit të kishës Katolike në Shqipëri dhe të mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, organizoi konferencën shkencore me temë “Drishti nga Lashtësia në Mesjetë”.

Në këtë konferencë ishin të ftuar personalitete të fushave të ndryshme, studiues, historiane, përfaqësues të institucioneve kulturore të qytetit, përfaqësues fetarë të besimeve të ndryshme, por edhe njerëz të thjeshtë të interesuar për këtë temë.

Relator i konferencës ishte Dr. Paulin Pushimaj, arkeolog.

Pas një prezantimi të shkurtë të Dr. Pushimaj nga moderatori i konferencës, z. Luigj Mila, sekretar i përgjithshëm i Komisionit Drejtësi dhe Paqe, u vijua më tej, në baze të programit.

Pozicioni strategjik i kështjellës së Drishtit, e vendosur në kodrat e Drishtit dhe e kufizuar nga lumi Kir, e bënte atë një qendër shumë të rëndësishme tregtare, kulturore dhe fetare gjate periudhës së Mesjetës. Kjo veçanti e kështjellës së Drishtit nuk u la pas edhe nga prezantimi i Dr. Pushimaj, i cili e filloi fjalën e tij duke falënderuar te pranishmit dhe veçanërisht Imzot Angelo Massafren për vënien në dispozicion të ambienteve të Muzeut Dio-



Dr. Paulin Pushimaj e Luigj Mila qezan për zhvillimin e kësaj konference.

Më pas ai vijoi me prezantimin e punës së tij në majën e Muzhiles, e cila ndodhet në kodrën përballë kështjellës së Drishtit. Pikërisht, në këtë kodër ndodhet edhe kisha e Shën Mërisë, objekt i

punës së Dr. Pushimaj. Ai prezantoi para të pranishmëve gërmimet e zhvilluara nga ai, në të njëjtën kohë duke shpjeguar edhe rëndësinë shpirtërore, kulturore, artistike dhe arkeologjike të këtij objekti, të shoqëruar edhe nga disa foto të shkrepura gjatë kryerjes së punimeve.

E veçanta e punimeve në këtë sit arkeologjik të rëndësishëm, është gjetja e një varreze masive në qendër të kishës, ku janë zbuluar një sasi e madhe eshtrash njerëzore të përziera edhe me eshtra kafshësh. Pikërisht kjo e bën më të veçantë këtë vend gërmim. Për momentin nuk dihet arsyeja e vërtetë e ekzistencës së

një “varreze” të tillë, por mendimi i Dr. Pushimaj është shpërthimi i një epidemie dhe për të izoluar përhapjen e saj u vendos varrimi i të infektuarve në këtë “varrezë”. Gjithsesi, për momentin mbetet vetëm një hipotezë dhe për një rezultat më të qartë për ekzistencën e një vendi të tillë do të duhen gërmime dhe studime të mëtejshme.

Edhe kjo konferencë u zhvillua pikërisht për të kuptuar rëndësinë e këtij siti arkeologjik dhe për të parë mundësitë e vazhdimit të mëtejshëm të punimeve.

**Majk Mila,**  
Shkodër, 15. 01. 2020



# SHPIRTI ARTISTIK DUKAGJINAS PËRFAQËSON TRI HERË SHQIPËRINË NË EUROVISION

TRUMFON ARILENA ARA NË FEST 58 TRSH

Ariena Ara është kurorëzuar me çmimin e parë me këngën 'Shaj', me muzikë të Darko Dimitrov e Lazar Cvetkovski dhe tekst të Lindon Berishës, i njëjti autor i hitit të saj "Nëntori". Në vazhdimsin e sukseseve të saj trumfon në festivalin e 58 të këngës në RTSH. Jo vetëm një herë gjatë natës së fundit, publiku ka thirrur emrin e saj duke u ngritur më këmbë, ashtu si edhe në momentin kur u shpall fituese, spektatorët shpërthyen në thirrje e duartrokitje. Ajo dhe vetëm ajo arrit të dëpërtoj në shpirtin ardashës të Shqiptarve. Ajo nuk e luajti këngën ajo e perjetoi për vetë dhe për të tjerët, Këto emocione jemi mësuar të na i dhuroj Arilena.

**FELEMINDERIT!**

Vetë artistja u shfaq në skenë dhe mori kupën mes emocioneve të shumta. "Kjo është për ju" tha ajo duke ngritur kupën. Arilena do të përfaqësojë Shqipërinë në muajin Maj në Eurovision 2020.

Teksti i këngës "Shaj"  
Nuk e di, a të ka ndodh  
Të goditesh brenda fort  
Nga një shkëndijë

E bukur dhe e trishtë  
Sa të rrit edhe të lodh  
Reziston që ta lëshosh  
Të jep ndjesin, që nuk ka përfundim  
Dua ta shaj  
Peshën që nuk e mbaj dot, mbaj dot  
Po më tërheq ajo zvarr  
Më vjen që ta vras  
Atë që s'mund ta ndaj, ta ndaj  
Dhe më bën të ndjehem me faj  
Ka diçka më tjetëron  
Brenda meje po rënkon  
Të ulëras, t'ia fal apo ta vras?  
Nuk e di si ta gjykoj  
Më lëndon, por e duroj  
E ka një çmim  
Ky peng i shpirtit tim

Ariena Ara, ka lindur më 17 korrik 1998. E lindur dhe rritur në qytetin e Shkodrës. Gjyshi i saj Zef Gjelozi Ara, ishte një ndër kuadrot më të njohur të Dukagjinit i cili, fisnikërin dhe urtin e percollti edhe tek pasardhësit e tij. Luigji ishte djali i tij i cili e zbuloi dhe e ushqeu Arilenen më dashurin për artin dhe të bukurën. Arilena pas perfaqësimeve dinjitoze që e vogël në qytetin e lindjes, ajo

është fituesja e sezonit të dytë e emisionit shqipëtar X Factor. Ariena Ara është sensacion i ri i muzikës moderne shqiptare. Ky moment i shkëlqyer në karrierën e saj. Tirana e lidhi Arilenen me TV Klan, ku si fillim u prezantua në "Gjeniu i Vogel" dhe më pas ajo vendosi të konkurronte në X Factor Albania. Kjo ishte dëshira e babait të saj, i cili u nda nga jeta pak muaj para se Ariena të prezantohej në X Factor 2. Ariena fitoi kompeticionin duke i dedikuar fitoren babait të saj. Ajo fitoi dhe një kontratë menaxhimi nga organizatorët e spektaklit X Factor. Duke parë moshën e saj vetëm 15 vjeç, menaxheri i saj vendosi që mos të nxitohej me karrierën e Arilenës.

Në sezonin e 2 të X Factor Shqipëtar, i cili u mbajt nga 28 tetor 2012 deri në 31 mars 2013 në TV Klan. Ajo në audicione Tirana performoi një version akustik të Ana Johnsson's «Ëe Are». Ajo ishte e mentoruar nga Altuna Sejdiu në kategorinë e «vajzave». Në finale, ajo këndoi Mary J Blige's "No More Drama" dhe Rihanna's "Man Doën" dhe "S&M" si duet me trajneren e saj Tuna për fitore. Në vijim Ariena u angazhua në emisionin "Dance Ëith Me" 2 duke konkurruar me partnerin e saj Labi,

Në 26 shtator 2014 ajo lançoi këngën e saj të parë "Aeroplan", me videoklip që arriti mbi 2 milion shikime në rrjetin social YouTube. Pas këngës "Aeroplan" ajo publikoi këngën "Business Class" që gjithashtu kishte shumë shikime në YouTube si dhe këngën e saj të tretë të quajtur "Vegim" e dedikuar për vdekjen e babait të saj. Sukseset e saj kororëzohen në Fest 58 në RTSH duke e fituar vendin e parë.

\*\*\*

**Shpirti artistik Dukagjinas përfaqëson tri herë Shqipërinë në Eurovision.**

Luis Ejlli - "Zjarr e ftohtë" viti 2006

Frederik Ndoci - "Balada e gurit" viti 2007

Ariena Ara - "Shaj" viti 2020

Shqipëria për herë të parë mori pjesë në Festivalin Evropian të Këngës në vitin 2004 në Stamboll të Turqisë. Shqipëria u prezantua me këngëtareshen Anjeza Shahini dhe këngën Imazhi Yt që u punua në Anglisht «Image Of You». Shqipëria mori vendin e 4-të në Gjysmë-Finale dhe Vendin e 7-të në Finale me 106 Pikë. Kjo i mundësoi Shqipërisë finale automatike në vitin e ardhshëm.

Duke i uruar sukseset të mëtejshme Arilenës i themi FALEMINDERIT, që na ka bërë dhe vazhdon të na bëjë të ndjehemi krenarë për arritjet e saj.

**Roza Pjetri**



Viti	Artisti	Gjuha	Kënga	Pikët
2004	Anjeza Shahini	Anglisht	"The Image of You"	167
2005	Ledina Çelo	Anglisht	"Tomorrow I Go"	
2006	Luiz Ejlli	Shqip	"Zjarr e ftohtë"	58
2007	Frederik Ndoci	Anglisht, Shqip	"Balada e Gurit"	49
2008	Olta Boka	Shqip	"Zemrën e lamë peng"	67
2009	Kejsi Tola	Anglisht	"Carry Me in Your Dreams"	73
2010	Juliana Pasha	Anglisht	"It's All About You"	76
2011	Aurela Gaçe	Anglisht, Shqip	"Feel the Passion"	47
2012	Rona Nishliu	Shqip	"Suus"	146
2013	Adrian Lulgjuraj & Bledar Sejko	Shqip	"Identitet"	31
2014	Hersi	Anglisht	"One Night's Anger"	22
2015	Elhaida Dani	Anglisht	"I'm Alive"	62
2016	Eneda Tarifa	Anglisht	"Fairytale"	45
2017	Lindita Halimi	Anglisht	"Ëorld"	76
2018	Eugent Bushpepa	Shqip	"Mall"	162
2019	Jonida Maliqi	Shqip	"Ktheju Tokës"	
2020	Ariena Ara	.....	"Shaj"	.....

# SINDROMA BLU E PAS PUSHIMEVE TË FUNDVITIT: SI T'IA DALIM MBANË?



Suela Ndoja

Pushimet e fundvitit kanë shumë avantazhe për të gjithë ata që kanë mundësinë të marrin apo ti kenë ato. Përfitimet e tilla shtrihen përtej mundësive për tu arritur nga rutina e përditshme. Ka mundësi për ripërtëritje, psh shkëputje mendore nga puna, çlodhje, përmirësime në sjelljen prej turisti, etj. Pra, përgjithësisht, bëhet fjalë veçanarisht për një periudhë ku njerëzit kanë më shumë kontakt me familjen, me të afërmit dhe me shoqërinë.

Megjithatë, disa nga këto efekte pozitive duken të jenë afat shkurt pas nga ana tjetër ka një shuarje të këtyre efekteve sapo i kthehen jetës së përditshme. Ja, ky është pikërisht muaji i parë i janarit, që do të thotë se jemi rikthyer në aktualitet dhe në punë si zakonisht. Për disa, është një lehtësim i madh. Edhe me të gjitha lajmet dhe brohoritjet e tij të mira, është një kohë e kërkuar financiare, fizike dhe emocionale e vitit. Sipas të dhënave për Shëndetin Mendor, 64 përqind e njerëzve raportojnë se preken nga depresioni i festave dhe kjo shpesh shkaktohet nga stresi financiar, emocional dhe fizik i stinës. Por, për të tjerët, duke zbritur nga niveli i lartë pas kohës më të mrekullueshme të vitit (dhe kthimi i pashmangshëm në punë) mund të sjellë edhe një pjesë të një gjendje kontrasti pas pushimeve. Përse? A keni menduar ndonjëherë pse është kaq e vështirë të riktheheni në lëvizje pas pushimeve? Bëhet fjalë për **gjendjen blu pas pushimeve**. Si ta njohim, cilat janë shkaqet dhe si t'ia dalim mbanë?

• **Çfarë është saktësisht gjendja blu pas pushimeve?** Kjo gjendje është e njohur gjithashtu si **Sindroma Blu pas Pushimeve**, stresi ose depresioni; kjo rënie në vetvete mund të godasë fort pas një periudhe emocionale dhe stresi intensiv. Gjendjet blu pas pushimeve ndajnë shumë nga të njëjtat simptoma karakteristike të një ankthi ose çrregullimi të humorit: pagjumësi, energji të ulët, nervozizëm, vështirësi në përqendrim dhe ankth. Por ndryshe nga depresioni klinik, shqetësimi i kësaj natyre është afatshkurt dhe jo afatgjatë. Megjithatë vëmendje shumë më e madhe i kushtohet shpesh depresionit që ndodh gjatë pushimeve, gjendja nuk është aq e pazakontë. Pra, çfarë e shkakton këtë mungesë të

ndritshme të shkëlqimit pas pushimeve?

- **Çfarë i shkakton gjendjet blu pas pushimeve?** Ekzistojnë relativisht pak kërkime mbi këtë temë, por mirëkuptimi midis ekspertëve është se rënia e adrenalinit është faktori kryesor. Psikologu klinik Dr. Eileen Kennedy-Moore sugjeron që tërheqja e menjëhershme e hormoneve të stresit pas një ngjarjeje madhore, qoftë ajo e dasmës, i një afati të rëndësishëm apo festave, mund të ketë një ndikim të thellë në mirëqenien tonë biologjike dhe psikologjike. Por kjo është vetëm një pjesë e ekuacionit. Efekti i kontrastit, një formë e perceptimit tonë të ndryshuar si rezultat i ekspozimit ndaj diçkaje me karakteristika të ngjashme, por me cilësi të ndryshme kyçe, është gjithashtu në lojë. Është në thelb mënyra e trurit për të provuar rivendosjen e rregullave, ndërsa përshtatet midis përvojave dukshëm të ndryshme. Dhe, gjysma e muajit dhjetor është në thelb një largim i madh nga rutina normale.

- **Pse e ndiejmë gjendjen blu pas pushimeve? Në qoftë se nuk janë bërë pushime dy ose tre javore në gusht ose ndonjë çlodhje tjetër të madhe gjatë vitit, pushimet mund të jenë e vetmja kohë që ndërpritet rutina e rregullt. Përsa e konsiderueshme e lundrimit në situata dhe marrëdhënie të vështira dhe për të mbajtur një gjendje të freskët gjatë ngjarjeve të festave është një tjetër faktor i mundshëm në depresionin pas pushimeve. Sipas Dr. Judith Orloff, psikiatër dhe autor i «Duke Lulëzuar si një Empatik», vendosja e një fronti të rremë dhe lumturia e fortë mund të jetë tepër shtrënguese. Kjo ide ndahet nga psikoterapisti Dr. Richard O'Connor, i cili ka një teori që ne «armatosemi» gjatë periudhës së festës si një mekanizëm përballës për t'ia dalë mbanë me stresin, emocionet dhe situatat e vështira. Gjithashtu edhe dieta e përbërë me sheqer dhe me pije mund të jetë faktor ndikues që pas një periudhe zgjatjeje gati një muaj, mund të mos ndjehemi aq mirë. Edhe nëse pushimet nuk ishin aq të gëzuara dhe të ndritshme, truri ekzagjeron realitetet e jetës së përditshme, duke e bërë kthimin në aktualitet të duket në një mënyrë jo proporcionale më shqetësuese dhe dëshpëruese sesa është në të vërtetë. Pra, nëse jemi**

A e keni ndjerë ndonjëherë gjendjen blu pas pushimeve?



kënaqur me pushimet tona, dhe nëse do të ishim më mirë me pushime sesa të kthehemi në punë, truri ynë është i detyruar të na bëjë të besojmë se i kemi bërë, ose se do ta dëshironim sërish. Duke vepruar kështu, ne paguajmë koston emocionale për një pushim të gëzuar dhe përjetojmë një kthim tregtar drejt bazës sonë të mirëqenies.

**Si t'ia dalim mbanë?**

**Në mbyllje:** Të punuarit me veten pas pushimeve kërkon për të vendosur një theks të veçantë mbi bazat e mirëqenies fizike dhe mendore dhe për të rregulluar pritshmëritë. Janë të rrekomandueshme si në vijim:

- **Kujdesi për veten.** Gurthemelë të shëndetshëm të jetesës për të rritur gjendjen shpirtërore dhe për të menaxhuar simptomat e gjendjes blu janë gjumë cilësor, meditim, stërvitje

e rregullt dhe një dietë ushqyese. Midis festave të natës vonë, vakteve me sheqer dhe listave të gjata për të bërë, këto praktika shpesh bien në buzë gjatë sezonit të festave. Ri-vendosja e tyre si një element i rregullt dhe jo i negociueshëm në rutinën e përditshme është thelbësore për t'u rikthyer në rrugën e duhur nëse përballeni emocionalisht.

- **Programimi i kohës për argëtim.** Ndërveprimi social është një komponent kritik i mirëqenies së përgjithshme. Tani që festat kanë dalë nga skena, një kalendar i zbrazët mund të ndihet pak depresiv. Mbushja e kalendarit me aktivitete të pëlqyeshme do t'ju

japë diçka që të shikoni përpara dhe të ndihmojë për të mbajtur efektin e kontrastit në gj. Është e lehtë të tërhiqeni kur ndjeheni poshtë. Arritja në dhe për të gjetur kohë për miqtë dhe njerëzit e tjerë që ju interesojnë - edhe kur nuk e ndjeni - gjithashtu mund të sigurojë një nxitje shumë të nevojshme.

- **Të qënurit të durueshëm dhe të lehtë me veten.** Gjendja Blu pas pushimeve nuk do të qëndrojë përgjithmonë. Ndërkohë, jepini vetes pak kohë të lirshme. Mos u mërzi për tu ndjerë në mënyrë që dëshironi dhe për të marrë kohën e nevojshme për të gjetur bazën tuaj. Nëse simptomat vazhdojnë, atëherë është e nevojshme për të konsideruar këshillimin me një specialist të fushës.



# NË SOFRËN E DUKAGJINIT NË NEË-JORK-U SHPALOSËN VLERAT MË TË MIRA TË FOLKLORIT DUKAGJINAS

Trashëgimia kulturore e Dukagjinit po pasurohet nga viti në vit me krijimet dhe interpretimet e reja në veprimtaritë e ndryshme që zhvillohen kudo ku ka shqiptar e në veçanti ku ka dukagjinat. Më të dendura këto veprimtari zhvillohen në çdo fund viti, duke e pasuruar si në sasi e cilësi trashëgiminë kulturore-artistike. Nuk ka rëndësi çfarë emri i vënë veprimtarisë: sofrë, tërvësë apo nata të ndryshme tradicionale, rëndësi ka që ato të zhvillohen kudo në botë ku ka dukagjinat dhe të kenë sa më shumë krijimtari të reja. Është për tu përgëzuar dhe entuziazmuar, sepse kudo ku ka dukagjinat, edhe pse të larguar nga vendlindja, mbartin me vete atdashedashurinë, vetitë e virtytet më të mira të trashëguara që i qëndrojnë kohës dhe bëjnë përpjekje për të mbajtur gjallë vlerat më të mira kulturore e artistike duke e pasuruar ato.

Në fund të vitit që lamë pas, e pikërisht me 19 dhjetor, u zhvillua një veprimtari folklorike në NEË-JORK të Amerikës, organizuar nga shaljami shqiptaro-amerikan, bujari e mikpritësi i pashoq, artdashësi dhe biznesmeni i suksesshëm Kujtim Funiçi. E emërtuan "Sofra e Dukagjinit" në NEË-Jork dhe asnjë veprimtari të tillë nuk i shkon më për shtat kjo emërtesë, sepse të gjithë këngëtarët ishin dukagjinat dhe si në asnjë veprimtari tjetër shkëlqyen kostumet tradicionale dukagjinase, ku, për ta ruajtur të gjallë trashëgiminë kulturore e etnografike dhe për t'iu transmetuar brezit të ri, z. Kujtim Funiçi, me shpenzimet e tij ka blerë 30 palë kostume tradicionale në Shkodër dhe sjellë në Amerikë për t'i pasur për çdo veprimtari kulturor e artistik edhe në të ardhmen.

Për këtë veprimtari kishin ardhur këngëtar e krijues nga Shqipëria, Italia dhe ata që jetojnë në Amerikë, duke u paraqit me krijime të reja, ku kishte përfaqësues pothuajse nga të gjitha trevat e Dukagjinit e asnjë të ftuar nga zonat e tjera, në antipod me disa veprimtari të cilat emërtesën e kanë dukagjinase, por që dominojnë këngëtarët e ftuar. Kjo veprimtari u zhvillua në një ambient shumë festiv, në skenën e të cilit rrezatonin kostumet shumëngjyrëshe të moshave e gjinive të ndryshme. Moderatorin, nipi i dukagjinit, Gjovalin Nikçi i shoqëruar nga gazetarja Erjona Rusi prezantojnë njërin pas tjetrit interpretuesit e folklorit dukagjinat, kryesisht krijime të reja. I pari u ngjit në skenë bilbili i flokut të veriut e atij shqiptar, Gëzim Nika, i cili jo vetëm nuk kurseu zërin e tij duke i dhënë gjallëri ambientit, por kontribuoi edhe në organizimin e kësaj veprimtarie. Ai e çeli programin me një këngë me lahutë me vargje të Fishtës. Ky i kënaqi pjesëmarrësit edhe me interpretime të tjera.

Enkas për këtë veprimtari kishin ardhur nga Shqipëria dyshja e talentuar dhe shumë e

pëlqyer e trevës së dukagjinit Ndue Shytani e Fran Kodra, ku ky i fundit ishte edhe drejtues artistik i aktivitetit, të cilët fillimisht interpretuan shumë cilësisht krijimin më të ri të tyre me titull "Nuk ka kund si Shkodrën tonë", që ndër të tjera thuhet: "Kudo ka shkodoranali / ka flamur e çifteli / këngë e valle e traditë / n' djepin tan lum kush asht rritë / shkodoranali më ka rrit nana / kurrë atë emër nuk e shes / sa t'jet Dielli edhe Hana / unë për Shkodër lind e vdes /"

Këngëtarja Bukurie Funiçi, zërin e së cilës na kishte marrë malli me e ndie, u paraqit me këngën "Ka thanë diell e ha

Toplana, e cila shumë cilësisht interpretoj këngën "Jam shqiptonjë", Lekbasi Lekë Pecnika, anëtar i Ansambllit të këngëve e valleve popullore, u paraqit me këngën "Kullat e vendlindjes", për interpretimin e të cilit është i tepërt çdo koment.

Këngëtarin e ri, por tanimë i afirmuar, Pëllumb Vatnika interpretoj këngën shumë të pëlqyer "Nimozot e ora e Shalës" ku ndër të tjera thuhet: "Sa t'jenë tokë e sa t'jenë qiell / sa t'jenë Hanë e sa t'jenë Diell / gjithmonë kanë me i thanë fjalës / nimozot e ora e Shalës". Nusja e dukagjinit, perla e folklorit puk-

Nika.

Një punë të lavdërueshme kishte bërë koreografja e talentuar, bija e Thethi, Angelina Nika, e cila me shumë profesionalizëm, kishte formuar një grup baleti me të rijnë të lindur në Amerikë, të cilët jo vetëm shoqëruan të gjitha këngët, zburkuran skenën por interpretuan valle të ndryshme në grup dhe dyshe karakteristike, duke mbajtur gjallë edhe në vendin ku banojnë etnografinë dhe motivet e bukura të valleve nga e kanë origjinën.

U mirëprit nga të pranishmit edhe kënga e bukur dhe shumë e kërkuar "Çika e bukur e dukagjinit" e kënduar nga Gëzim Nika.

Përveç kontributit organizativ e financiar të z. Kujtim Funiçi, i cili edhe mbajti për dy javë këngëtarët e ardhur nga larg me kushte të jashtëzakonshme; sofrën e pasuruan me ndihmesën e tyre edhe dukagjinat e suksesshëm Lin Kumbulla, Kujtim Mali e Ndreka Tonaj.

Kjo natë u mbyll në mënyrën më të mirë të mundshme, me një këngë me vargje të poetit të madh Naim Frashrit, dalë nga një bashkëpunim i kompozitorit shumë prodhimtar Kolë Susaj me Gëzim Nikën, i cili ishte solist i shoqëruar nga grupi. Kënga ishte "Shqipëri o nëna ime", e cila ka kohë që është bërë himn dhe këndohet masivisht në shumë veprimtari. Vargjet e saj janë shumë aktuale edhe sot si: "Shqipëri o nëna ime / ndonë se jam i mërguar / dashurinë tënde / kurrë zemra s'ka me e harruar/...

Bujaria dhe mikpritja e z. Funiçi nuk kishte të sosur. Ai, në festën e fisit nga vjen-Shëngjonin e Shalës, ftoj të gjithë grupin atë natë ku kënga e gëzimi vijoi deri në mëngjesin e ditës pasardhëse. Këtë veprimtari artistike, shumë mbresëlënëse e regjistroj TV- Blue Sky e Gëzim Brahushës të cilin e dha në natën e ndërrimit të viteve për artdashësit e qarkut Shkodër dhe u pëlqye shumë.

Siç e theksuam më lart, nga dukagjinat e NEË-Jorkut, me këngëtar vetëm dukagjinat, u zhvillua një koncert folklorik i pari i këtij lloji, i cili e pasuroj trashëgiminë kulturore me këngë e valle shumë cilësore në një natë të paharruar në prag të festave të fund vitit. Të tilla veprimtari duhet të zhvillohen edhe në të ardhmen kudo ku ka shqiptar e sidomos dukagjinat, që nga Thethi deri në Australinë e largët, larg xhelozive, hatër mbetjeve e përjashtimeve, por ne unitet e bashkëpunues të gjithë këngëtarët dukagjinat kudo që janë si dhe sa më shumë sipërmarrës për mundësimin e tyre, duke rrit kështu fondin e artë të trashëgimisë kulturore dhe duke e pasuruar atë nga viti në vit.

PRELË SHYTANI,  
JANAR 2020



në"

Në këtë natë të paharruar nuk kishte si të mungonte i talentuari, interpretuesi i shkëlqyer i folklorit, i kudo ndodhuri, ku e thërret çdo veprimtari folklorike, që nga kënga "Atje ku mbretër janë të tanë" e deri në SHBA, Nikë Çarku, i cili u paraqit me një këngë "Për pajtim gjaqesh" si dhe këngën e tij himn "Atje mbretër janë të tanë", me të cilat fitoj duartrokitjet frenetike të të pranishmëve.

Është shumë pozitiv fakti që dëshira për folklorin dhe interpretimin e tij po transmetohet edhe tek brezi i ri. Këtë e tregoj 11 vjeçarja e lindur në Amerikë, Elsa Kapaj, degë e pemës Kapaj nga

Jan, Zoja Pali, me zërin e saj melodioz dhe të kthjellët si ujët e burimeve të bjeshkëve tona, interpretoj dy këngë: "Një për gurë - themelin e gjuhës shqipe", që u shkri për fe e Atdhe - Pjeter Bogdani dhe këngën "N'mes Parisit knoj alltia", këngë për Avni Rustemin.

Përsëri ata që i dhanë gjallëri kësaj veprimtarie, Fran Kodra e Ndue Shytani bashkë me Bukurie Funiçin, paraqitën tek spektatori një trio-lirike gazmore me titull "Furka plot e boshti thatë". E pasuruan këtë spektakël edhe vëllezërit Ndue e Gjon Nika, të cilët interpretuan këngë lirike e patriotike, kryesisht nga repertori i vëllait të tyre, të madhit Gëzim









# SHQIPTARËT DHE EUROPA E BRUKSELIT



ALFRED PAPAÇIU

Herë pas here u kthehem shënimeve, mesazheve nga ana e miqve të mi të mirë, që më shkruajnë lidhur me mendimet që shpreh në shtyp, sidomos për dëshirën time që edhe Shqipëria dhe Kosova të jenë një ditë në Evropën e Brukselit.

Një prej tyre është dhe profesori i ndëruar i gazetarisë shqiptare, Hamit Boriçi, i cili para do kohësh më shkruante: "Lexova ciklin e shkrimeve – mbrojtje e shkëlqyer e të drejtave të patjetërsueshme të Shqipërisë dhe të kombit shqiptar; aktakuzë kundër grupeve dhe individëve jo thjesht dashakëqij të Shqipërisë, por edhe politikanëve amoralë në Evropë e Shqipëri; avokaturë mjeshtërore me dituritë e një diplomati e publicisti për çështjet ballkanike, europiane dhe më tej.

Artikujt janë mbrytur me fakte dhe interpretime kompetente, shprehur me retorikë racionale, por edhe emocionale. Ju nuk keni qëndruar indiferent ndaj kësaj padrejtësie të radhës të paprincipitë që i bëhet Shqipërisë dhe Ballkanit, por u ngritët si tribun i drejtësisë kombëtare e ndërkombëtare, duke u dhënë një shembull edhe politikanëve dhe diplomatëve tanë. Ju përgëzoj edhe për stilin dinamik që përshkon artikujt tuaj; për mjeshtërinë e komunikimit, duke u servirur lexuesve të interesuar dhe të painteresuar, informacione, fakte dhe argumente të pakundërshtueshme.

Me respekt të veçantë, Hamiti".

Këto mendime të shprehura janë pasqyrimi i një qëndrimi origjinal dhe të lirë. Ai lidhet me mendimin e përhapur te një pjesë e opinionit europian: Europa u përket të gjitha shteteve dhe banorëve që e përbëjnë atë, pra, duke përfshirë edhe "Europën tjetër", ku bëjmë pjesë edhe ne, Shqipëria, Kosova, Zvicra dhe një numër shtetesh të tjerë që janë akoma jashtë saj. A do ta mendojë këtë stafi i ri, drejtues i Europës së Brukselit, që tashmë është krijuar?

Këtë do ta tregojë koha, nëse vizioni i tyre për Europën pa kufi që e kanë menduar baballarët e Europës disa dekada më parë, do të bëhet më në fund realitet. Studimi i çështjeve europiane më ka shtyrë të gërmoj më tepër për vlerat e individit, lirinë, pluralizmin, shtetin e së drejtës, të drejtat e njeriut dhe përparësinë e demokracisë. Nuk i kemi njohur më parë apo më mirë të themi nuk na i kanë mësuar në shkollë, figurat e atyre që shkruanë energjitet për Europën, si Viktor Hygo, Robert Shumani, Jean Monnet, Henri de Saint Simon, Konrad Adenauer, Çurçilli,

Altiero Spinelli, Alcide de Gasperi, Paul-Herri Spaak, Denis de Rougemont, Alfred Borel.

Monumenti "Homazh për Etërit Themelues të Europës", përpara shtëpisë së Robert Schumanit, në ScyChazelles nga artisti Zurab Tsereteli, zbuluar në 20 tetor 2012, përfaqëson katër themeluesit e Europës – Alcide de Gasperi, Robert Schuman, Jean Monnet dhe Konrad Adenauer. Kontinenti europian kufizohet në përfundim me Oqeanin Atlantik, në veri me Arktikun dhe në jug me ngushticën e Gjibraltarit, Detin Mesdhe, Detin Egje, Ngushticën e Dardaneleve, Detin e Marmarasë dhe Ngushticën e Bosforit. Kufijtë e Europës në lindje janë më pak të dukshme, sepse nuk ka pengesa kryesore natyrore. Në mitologjinë greke, Europa është një princeshë fenikase. Në veprat e Homerit, Europa është një mbretëreshë mitologjike e Kretës dhe jo një term gjeografik. Më vonë, fjala nënkuptonte Greqinë kontinentale që nga viti 500 para Krishtit. Pas Krishtit, kuptimi i saj përmban gjithë tokën në veri.

Ndërsa në përfundim të kontinentit, shtete relativisht të fuqishme u zhvilluan rreth vitit 1000, në lindje kombet e lindura shpejt u gjendën nën mbikëqyrjen ekonomike, kulturore dhe mbi të gjitha fetare: Perandoria Bizantine dhe më pas Perandoria Osmane. Ky është veçanërisht rasti në Ballkan, ku popujt të tillë si bullgarët, serbët dhe rumunët, përgjatë mesjetës deri në fund të shekullit XIX, ishin në pozitën e vasalëve. Kjo do të shpjegonte pjesërisht dobësinë e institucioneve demokratike në shtetet e Ballkanit, që nuk kanë shumë kohë që janë krijuar.

Që nga viti 1989, historia e Europës ka pasur ndryshime të thella. Në Lindje, regjimet komuniste u "fundosën" dhe lindën nacionalizmat. Europa pa të lindin si kërpuhat pas shiut, shtete-kombe, shpesh në luftë me njeritjetrin. Tanimë, shihet një formë tjetër e bashkimit midis vendeve europiane të Lindjes dhe të Perëndimit. Shqipëria tashmë bën pjesë në institucione të rëndësishme të bashkëpunimit ekonomik, politik dhe ushtarak në Europë: në Këshillin e Europës, në Konferencën për Sigurimin dhe Bashkëpunimin në Europë, në Aleancën e Atlantikut Verior, në organizma europiane të Kombeve të Bashkuara, si Komisioni Ekonomik i OKB-së për Europën, si dhe ka paraqitur kërkesën për integrim në Bashkimin Europian.

Qasjet gjeografike dhe gjeopolitike të kontinentit europian kanë marrë parasysh ndryshimin e shkallës së Bashkimit Europian që nga zgjerimi i madh i 2004-2007. BE e 27-29 në 2012- e ka vendosur veten si sistemin qendror të organizimit politik në kontinent. Sidoqoftë, nëse e kthejmë pikëpamjen dhe ne e konsiderojmë kontinentin në tërësi, vërejmë se BE përmbledh "vetëm" 27 shtete, nga 49 që përbëjnë kontinentin në përkufizimin e tij, të mbajtur nga Këshilli i Europës (47 shtete anëtare + Bjellorusia të pezulluara që nga viti 1997 + e njohën pjesërisht Kosovën). Në vitin 2010, mbi një sipërfaqe prej 4,376,780 km<sup>2</sup>, BE kishte 500.3

milionë europianë ose 42.1% të zonës së përcaktuar nga Këshilli i Europës, nga 10,392,855 km<sup>2</sup> dhe 826 milionë banorët e interesuar.

Në të gjithë kontinentin brenda kufijve të tij konvencionarë, BE ka 68.2% të popullsisë. Dhe të tjerët? Europa jashtë – BE mbledh kështu 22 shtete – një numër që ka rënë në vite – të cilat janë shpërndarë shumëllojshëm në të gjithë kontinentin, me madhësi shumë të ndryshme dhe peshë ekonomike dhe demografike. Ato gjithashtu ndryshojnë në natyrën dhe intensitetin e marrëdhënieve të tyre me BE-në. Shkurt, nuk mund të flasim për një tërësi homogjene, as politikisht, as gjeografikisht. A e bën kriterin e anëtarësimit jo-BE, në një element të unitetit në një grupim të tillë? Cilat pika të përbashkëta mund të ketë ndërmjet Moldavisë, e cila ka GNP më të ulët për frymë në kontinent (1,229 €/banor) dhe Zvicrën (45,814 €/banor)? Midis Rusisë së gjerë dhe shumë të populluar (17,098,241 km<sup>2</sup> për 141 milionë banorë) dhe Principatës së Andorrës (468 km<sup>2</sup> për 95,000 banorë)? Sidomos pasi që është e nevojshme të shtohen në këto 22 shtete, territoret europiane që i përkasin një shteti anëtar, por që nuk janë pjesë e BE: Ishujt e Kanalit (Jersey, Guernsey), Man, ose Faroe, si dhe bashkitë italiane të Livigno dhe Campione d'Italia (i bllokuar në Zvicër). Këto mikro-territore kanë gati 250,000 banorë.

Natyra dhe intensiteti i marrëdhënieve me BE-në, vendi i shteteve ose grupimet e shteteve në arkitekturën gjeopolitike të kontinentit mund të japin një çelës të qasjes gjeografike të kësaj tërësie. Fakti është se ekzistojnë kategori të ndryshme të shteteve, të cilat është e mundur të identifikohen nga profili i tyre dhe konceptimi i tyre për marrëdhëniet e tyre me BE: mospranimet vullnetare, planifikimet që të bashkohen afatmesëm, afrimi strategjik me qëllim të ribalancimit politik dhe / ose ekonomik... kur pyetja është unanime brenda elektoratit dhe grupeve politike kombëtare! Ne mund të identifikojmë disa grupe shtetesh të shqetësuara nga probleme të ndryshme: shtetet e EFTA-s, ato të CEFTA (Shoqata e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore), ato të CIS dhe mikroshteteve. Rusia dhe Turqia janë raste të veçanta për shkak të peshës së tyre ekonomike dhe demografike.

Këto dy shtete gjithashtu kanë karakteristikën e përbashkët të territorit të tyre kombëtar. Për të shkuar më tej në Europën e Re që nuk dihet kur do realizohet, duke nxitur kështu shtete dhe forca jashtë Europës të marrin, ndoshta primatin. Nën shembullin e Komunitetit Europian që i bashkoi armiqtë tradicionalë, sapo kishte mbaruar lufta, popujt e vendeve të tjera europiane që nuk bëjnë akoma pjesë në Europën e të 27-tëve, pra, janë në "Europën tjetër", si Zvicra, Shqipëria, Kosova dhe disa vende të tjera europiane, do t'i sjellin asaj një frymë të re bashkëpunimi dhe paqeje në kontinent. Pra, nga 49 vende që e përbëjnë kontinentin europian, vetëm 27 prej tyre ndodhen në Europën e Brukselit. A mos bëhet kjo enkas për ta mbajtur përsëri një pjesë të Ballkanit dhe

të Europës si fuçi baruti, që popujt që e përbëjnë atë të mos jenë të qetë? Shqiptarët nuk kërkojnë ndërrime kufijsh, me futjen e tyre në Europë, megjithë padrejtësitë që u bënë atyre, disa shtete europiane, në vitin 1913, që për çudi janë krijuar si të tilla, shumë më pas Shqipërisë dhe Kosovës.

Ishin këto padrejtësi historike, siç dëshmojnë analistët largpamës, që do të sillnin ndeshje, gjak, mëri, dhunë dhe lot deri në fillimin e shekullit të XXI, që detyruan Imzot Gjergj Fishtën të akuzojë: "Uh! Europë, ti kurva e motit!/Që i re mohit, besës së Zotit!/Po, á ky asht sheji i qytetnisë?/Me da token e Shqypnisë". Në fundin e shekullit të XX, situata gjeopolitike e Europës Juglindore ka ndryshuar. Demokratizimi i kësaj pjesë të Europës ka mundësuar jo vetëm çlirimin e Shqipërisë nga diktatura komuniste, por është krijuar një entitet i ri në Ballkan. Republika e Kosovës, vend sovran, i lirë dhe i demokratizuar, të cilin shqiptarëve ualënë jashtë në Londrën e vitit 1913, po përpiqen aktualisht të përparojnë në liri, demokratizim dhe europianizim. Problemi çam nga "tabu" është kthyer në temë e ditës në bisedimet ndërkombëtare..

Sot, pas mbi 100 viteve ndarjeje, shqiptarët janë një faktor i pranuar nga Europa, në procesin e njohjes së vlerave perëndimore të lirisë, demokratizimit. Kombit i janë hapur mundësitë për të shfrytëzuar këtë rast, për ta bashkuar atdheun e tyre në një Europë të të njëjtave vlera. Në padrejtësitë që i bëhen popullit fisnik shqiptar, kanë dorë dhe lobet e fuqishme, sado të pakta, armike të Shqipërisë dhe Kosovës, që janë të lidhura me mafien ndërkombëtare. Ata i sollën fenomenet negative në Shqipëri, thjesht për interesat e tyre që ta shtyjnë pranimin e Shqipërisë në Europën e Brukselit sa më tepër që të kenë mundësi, të marrin ata akoma pjesën e luanit, në ndarjen e ndihmave europiane. Ata që i mbajnë akoma në dorë fatet e Shqipërisë dhe Kosovës në Bruksel, duhet ta dinë mirë se kanë qenë shqiptarët ata që i kanë mbajtur, gjatë Luftës së Dytë Botërore, në vatrat e tyre, pa i dorëzuar te nazistët gjermanë, mijëra italianë që kishin ardhur si pushtues. Ata u mbrojtën dhe u larguan vetëm pas mbarimit të kësaj Luftë. Janë me mijëra e mijëra ata grekë që kanë marrë ndihma nga shqiptarët gjatë Luftës Italo-Greke dhe, si mirënjohje, breza të tjerë të këtyre njerëzve humanë shqiptarë marrin pension nga shteti grek. A nuk duhet në këto çaste, këta miq të Shqipërisë, grekë, që për çudi mbeten më tepër miq të serbomëdhenjve, apo italianë, si edhe çifutë (të vetmit shqiptarët në Europë që nuk i dorëzuan hebrenjtë te xhelatët nazistë) të ngrënë zërin e tyre për të vënë në vend padrejtësitë ndaj shqiptarëve. Apo tashmë ata e "kanë kaluar lumin" dhe u intereson që edhe disa vite të përfitojnë nga puna e papaguar e atyre mijëra e mijëra shqiptarëve nga Shqipëria dhe Kosova, që rropaten rrugëve të Greqisë, Italisë dhe Europës?!

Nëse disa popuj, duke përfshirë dhe shqiptarët, si rezultat i pushtimeve të huaja, u detyruan të ndërro-

# FËMIJËVE U DUHET TREGUAR “KUFIRI”, QË NË FILLIM

Ditmiri është 14 vjeç. Shpreson që të dalë sa më shpejt nga burgu dhe të kthehet në shtëpi. Është dënuar për fyerje dhe plagosje të lehtë të mësueses, në orën e mësimit.

Ditmiri, ka kaluar një fëmijëri të hershme, të vështirë. Babin thuajse nuk e njeh fare dhe nëna e tij ka përjetuar vetëm dhunë nga i ati. Për të përbulluar dhembjet që i shkaktonte dhunimi i nënës, ai filloi të merrte drogë, të pinte alkool dhe largohej me ditë të tëra nga shtëpia. Në shkollë, ai shkonte sa për detyrim. Mendohej që t'i manipulonte shokët e vet që ta mbështesnin, të solidarizoheshin me sjelljet dhe qëndrimet e tij. Organizonte rezistencë dhe kundërshtoi ndaj mësuesëve, duke nxitur edhe të tjerët për një gjë të tillë. Shpesh e gjenin njerëzit diku të dehur, pa ndjenja dhe e çonin në shtëpi. I duheshin para për drogën dhe alkoolin dhe meqenëse nuk i siguronte në familje, filloi të vidhte, ku mundej dhe kë mundej. Ditmiri, shpesh vihet në dilemën, midis jetës dhe vdekjes: Ndoshta do të ishte më mirë sikur të vdisja! Unë nuk kam jetë, nuk jetoj si të tjerët!

Gjëja që Ditmiri nuk arriti ta mësonte kurrë, në fëmijërinë e tij të hershme është se, kufiri është liri. Kufiri nuk të kufizon por, është mbrojtje dhe siguri dhe nga të dyja këto, Ditmiri, thuajse nuk ka mësuar asgjë.

Kufiri tregon hapësirën e lëvizjeve, ku fëmijët dhe të rinjtë mund të lëvizin lirshëm. Sa më shumë që rritet fëmija, aq më shumë zgjerohet hapësira e tij lëvizëse. Fëmijët dhe të rinjtë, janë kompetent, brenda hapësirës së tyre.



Fëmijët e vegjël, vazhdimisht duhet të mbahen nën kontroll. Hapësira e lirisë së tyre është shumë e vogël. Megjithatë, brenda asaj hapësirë, edhe ata duhet të mësohen të mbajnë përgjegjësi për sjelljet dhe vendimmarrjet e tyre. Nëse fëmija i përplasë lodrat në mur, në shenjë proteste apo kur nuk done të luaj me vëllazërinë e vet, prindit duhet ta tërheqin menjëherë dhe t'i thonë: Ti mund të vazhdosh të luash vetëm nëse nuk i përplasë lodrat në mur dhe nëse pranon të luash me vëllain apo motrën.

Në klasat e para në shkollë, nga fëmijët pritet që, të bëjnë detyrat e shtëpisë, të dëgjojnë mësuesen dhe të mos flasin pa leje. Nëse nuk e bëjnë këtë vullnetarisht, u duhet imponuar. Sa më shumë që rriten fëmijët, aq më shumë zgjerohet fusha e

veprimtarisë së tyre, aq më të lirë janë ata dhe aq më shumë pritet prej tyre. Nëse fëmijët apo të rinjtë, nuk e justifikojnë me sjelljet dhe vendimmarrjet e tyre zgjerimin e zonës së veprimtarisë, duhet korrigjuar menjëherë, kufiri duhet të tkurret. Të rinjtë duhet domosdo të mësojnë që të mbajnë përgjegjësi për sjelljet dhe veprimet e tyre, brenda fushës së lejuar.

Kufiri duhet menduar siguri, mbrojtje dhe liri. Aty ku kufiri është i paqartë, ka grindje, dhunë, madje, edhe luftë. Ka kuptim të plotë shprehja: Kufiri i qartë, fqinjësi e mirë.

Nëse fëmijët dhe të rinjtë nuk e shikojnë dhe njohin kufirin, përse dhe për çfarë duhet të përgjigjen, nuk do të mund të mësojnë të mbajnë përgjegjësi për sjelljet dhe veprimet e tyre. Bota është e madhe, madje, shpesh shumë e madhe dhe e rrezikshme. Nëse prindërit nuk janë të gatshëm apo të aftë që t'u mësojnë fëmijëve kufirin, fëmijët, ose do të ngarkohen me përgjegjësi për të gjitha, gjë kjo që i rëndon ata, ose do të shfrytëzohen lirinë e tyre pakufi dhe, nuk do të mbajnë përgjegjësi për asgjë.

Për pjesën më të madhe të fëmijëve dhe të rinjve, është qetësues fakti se ata nuk ndejnë përgjegjësi për të gjitha ato që ndodhin në jetën e tyre dhe në mjedisin ku jetojnë. Vendimmarrjet e prindërve, për familjen dhe ato që ndodhin në botë, janë jashtë fushës së tyre.

Kufiri nuk duhet menduar si mbingarkesë për ata por, për të krijuar idenë se, brenda fushës së tyre, ata janë kompetent dhe të suksesshëm.

Fëmijët duhet të mësojnë se kufiri

është i fortë dhe i qëndrueshëm dhe, nëse duan ta kapërcejnë atë, nuk e kanë të lehtë. Duhet të mësojnë se, vetëm brenda kufirit të caktuar janë të lirë dhe të sigurte. Kjo liri dhe siguri janë funksionale vetëm nëse kufiri nuk do të injorohet. Është detyrë e prindërve dhe e shkollës që, të mbrohet ky kufi, edhe nëse fëmijët apo të rinjtë nuk e dëshirojnë atë. U duhet bërë e qartë se, mosrespektimi i kufirit, sjell zvogëlimin e sferës së lirisë së tyre. Mbyllet në shtëpi, në institucione të mbyllura apo dhe burg.

Prindërit që u diktojnë fëmijëve të tyre që në fillim kufirin e qëndrueshëm dhe të pakapërcyeshëm, i ndihmojnë fëmijët e tyre që të ndjehen mirë, të sigurt dhe të lirë, brenda atij kufiri. Nëse fëmijët do ta kuptojnë këtë, sigurisht që, kur të zgjerohet kufiri i tyre, nuk do ta shfrytëzojnë atë për aventura por, do ta ndejnë përgjegjësinë e tyre, për sjelljet, lirinë dhe vendimmarrjet. Ata nuk do të rrebelojnë por, do ta pranojnë gradualisht zgjerimin e fushës së veprimtarisë së tyre.

Të rinjtë priren nga tendenca e lirisë së pakufizuar por, nuk janë aspak të gatshëm të marrin përgjegjësinë për pasojat që mund të sjellë një gjë e tillë. Shpesh nuk duan të dëgjojnë fjalën e prindërve të tyre, duan liri të pakufizuar në familje. I duan të gjitha dhe tani, pa prekur asgjë me dorë.

Prindërit nuk duhet të dorëzohen, duhet të pyesin dhe të informohen rregullisht, nëse ndjehen të paafte për të kontrolluar fëmijët e tyre.

Lekë Imeraj,  
Gjermani – shkrimtar dhe përkthyes

◀ nin fenë apo i janë bërë dhe padrejtësi të tjera, kjo nuk do të thotë se nuk janë të denjë për të zgjeruar Europën e të 27-tëve dhe duhet të qëndrojnë përjetësisht në “Europën tjetër”. Të jesh në Europën e Brukselit apo edhe jashtë saj, është një mënyrë e përkohshme jetese, në të përditshmen e një qytetari europian, për të cilën unë shprehen pa prapamendime... Të gjithë jemi të ndërvarur dhe të lidhur me njeritjetrin. Sipas mendimit bashkëkohor “Individualiteti” ka kuptim vetëm kur je në një grup dhe kur shkëmben mendime, por edhe kulturën etj., me të njëjtën barasvlerë. Shumë vende që hynë vite më parë apo edhe vitet e fundit në Europën e Brukselit dhe u shkëputën nga “Europa tjetër”, nuk kishin të njëjtin nivel zhvillimi konkretizimin e saj punuan me dashuri dhe profesionalizëm të lartë, veçanërisht një dorë diplomatësh të spikatur, midis të cilëve do të përmendja Spiro Koçin, Mimoza Halimin e ndonjë tjetër. Më pas ata do të bëheshin edhe ambasadorë të shkëlqyer.

Kam mësuar shumë nga bashkëpunimi me ta vijon nga faqja 1 mi, siç e kanë sot, pasi kanë marrë subvencione të shumta. Korrupsioni në “Europën tjetër” është i dukshëm dhe në anën e “civilizuar”. Kam një simpati të veçantë për Zvicrën. Zvicra nuk është anëtare e Bashkimit Europian, pasi kështu ka vendosur populli sovran i saj dhe nuk dihet se kur mund të bëjë

pjesë në të. Por ajo ka marrëdhënie të shkëlqyera dypalëshe me fqinjët që janë në Europën e Brukselit apo edhe më larg. Zvicra nuk e ndien mospraninë e saj si anëtare e Bashkimit Europian dhe ndoshta nuk ka nevojë për atë Europë “deri diku të korruptuar”. Zvicrën unë e admiroj dhe çdo herë që shkoj te miqtë e mi të shumtë zviceranë, si dhe bashkëkombës, apo udhëtoj diku nëpër territorin e saj, mrekullohem me ndryshimet galopante që shoh.

Por në asnjë çast nuk mund ta harroj vendin nga kam ardhur, Shqipërinë. Nuk mund të harroj atë kafën e mëngjesit aty në restorantin e vogël pranë shtëpisë, ku shpesh bisedoja miqësisht dhe lirshëm me mikun e mirë të tim eti, Tunit, Xhevati Beqaraj apo me profesorin e nderuar të Historisë së Francës në fakultet, Koli Xoxi, me babain e gazetarisë, prof. Hamit Boriçi, me profesorët e nderuar dhe miq të mi të mirë, Ksenofon Krisafi dhe Shaban Murati, me miqtë profesorë që mblidheshin te “Colosseum” çdo mëngjes. Nuk mund të harroj ato ditët e bukura, të kaluara buzë detit Adriatik dhe Jon, si dhe Semanit e Vjosës.

Nuk mund të harroj udhëtimet në rivierën shqiptare, ditët e bukura të kaluara në Sarandë, në atë mrekullinë e kafes së “Gjuetisë”, në Lezhë, në Valbonën, ku u mrekulluan miqtë e mi brazilianë, në Drilon, në Korçën me ato rrugët karakteristike, në Voskopojën e paraardhësve të

mi, si dhe atje buzë Gjanicës në Fier, prej nga e kam prejardhjen nga prindërit. Nuk mund të harroj Apoloninë, ku në fëmijërinë time shkoja shpesh te të afërmit dhe taksat dhe bisedoja me xha Pilon e Muzeut, por edhe shkrimtarin Jakox Xoxa, që shkruante “Lumin e Vdekur”. Nuk mund të harroj lagjen “Liri” dhe “Konferenca e Pezës”, po në Fier, ku jetonin gjyshërit e mi dhe ku kam kaluar çaste të këndshme dhe të lumtur. Ashtu si dhe për europianët që gjenealogjia është kthyer në një nga argëtimet më të preferuara, edhe për mua është kthyer në një argëtim për të plotësuar pemën gjenealogjike, të lënë me kujdes nga im atë i paharruar, Tuni. Shpesh pyesja edhe nënën time të ndjerë, si dhe motrën time apo edhe të afërm për emra dhe ngjarje të ndryshme. I shënoj ato me kujdes, për kënaqësinë time.


Të ndërtosh pemën tënde gjenealogjike, do të thotë të studiosh gjeografinë, historinë, demografinë, të gjesh kuptimin e fjalëve që janë përdorur nga paraardhësit. “Arbanasit”, kur u larguan nga vitet 1700 nga tokat e tyre amtare, u detyruan nga të tjerët të ndërronin emrin, siç u detyruan edhe shqiptarët e krishterë në kohën e otomanëve të ndryshonin emrat e tyre për të pasur një punë në administratën e asaj kohe. Megjithatë, të vërtetat dhe vlerat e një kombi nuk mund të shuhet. Nxisim edhe fëmijët tanë t'i kenë ato, si dhe fotografi të familjes, gjyshërve dhe

gjysheve. Bëri mirë Zografë Kokthi që na dërgoi jetëshkrimin e gjyshit dhe gjyshes së saj, luftëtarit me koburë, Dhimitër Kokoneshi, që të mos e harrojnë brezat e ardhshëm. Ato do transmetohen brez pas brezi. Është e vërtetë se gjuha jonë dihet se është e folur që në “kohën e Perëndive”, por historiografia perëndimore i ka anashkalluar disa herë të vërtetat historike, sidomos të Shqipërisë dhe Kosovës.

Është e vërtetë që nga “padija” apo enkas, bashkë me qengjat shqiptarë, u grabitën dhe u shitën për dy kacidhe edhe zbulime arkeologjike, në ato vende që akoma i shkojnë për hosh për interesa të ngushta Beogradit dhe jam i bindur që kanë ndikuar në vendimmarrjen famëkeqe të deridjeshme. Por ato nuk mund ta lënë Shqipërinë në një “Europë tjetër” për shumë kohë. Komuniteti Europian është një arritje e mirë e një projekti të paqes që mbështetet në përvojat e shumta të shkëmbimeve midis popujve të kontinentit. Europa në tërësi do të forcohet në mënyrë të vërtetë, vetëm në sajë të solidaritetit me të gjithë botën që e përbën atë dhe jo me një “ndërtim” të një fortëse të rremë dhe egoiste. Edhe Skënderbeu, për të cilin u flas miqve të mi europianë, është pjesë e pasurisë së përbashkët europiane. Edhe Nënë Tereza, Isa Boletini, Adem Jashari, Bubulina, Shota Galica, Zhan D'Ark, si edhe Vilhelm Teli i Zvicrës.

# FIBROZA CYSTICE (MUKOVISHIDOZA)

Fibroza cistike është një sëmundje gjenetike pak e njohur për trajtimin e përgjithshëm në popullsi sidomos në vendet Lindore. Raportohet se 1:27 persona janë portator të gjenit CFTR (cistik fibrosis transmembranor rregullator) pa pasur asnjë shenjë dhe 1:1000-6000 lindje preket nga sëmundja psh në Itali ka rreth 3500 të sëmurë në qendrat rajonale, dhe në vendin tonë ka raste sporadike, por nuk ka një studim të mirëfilltë. Në formën më të rëndë fibroza cistike prek organet kryesisht pankreasin (nga ku emërtohet fibroza cistike pankreatike) dhe organet e tjera si mushkëritë, melcia dhe zorrët. Dëmtimi i pankreasit është i hershëm dhe provokon vështirësi në tretje dhe në përvetesimin e yndyrnave me kohën fëmijët mund të vdesin nga kequshqyerja, por prej shumë kohësh për fat të mirë ky aspekt i sëmundjes është i korigjueshëm. Dëmtimi i mushkërive shfaqet pak a shumë vonë me procese infektive të përsëritura deri në infeksionet kronike që dëmtojnë në mënyrë progresive dhe të pakthyeshme indin e mushkërisë. Veç kësaj, shfaqje kryesore fibroza cistike provokon diabetin në 15% të të rinjve, sëmundje të rëndë atë melcisë në 3% të të rinjve, pankreatit rekurent, sterilitet mashkullor e femëror në disa raste, polipoze në hundë dhe okluzion intestinal (ngatrrim zorrësh). Ekzistojnë dhe forma klasike të fibrozës cistike ku janë prezent shenja kryesore që përkruhen si insuficence pankreatike, insuficence respiratore dhe në 20% të pacientëve ku nuk është prezent shfaqja në zorrë, pankreasi është në normë dhe pastaj në muajt e parë të jetës rritet mirë pa nevojën e shtesave. Megjithatë ka forma me dekurs të lehtë të shfaqura vonë, me forme atipike e cila mund të korigjohet në moshën madhore. I njëjti mutacion (transformim) i genit CFTR gjendet në pacientet me shprehje të ndryshme të sëmundjes. Me pas, gjenetika nuk ndihmon parashikimin e ecurisë. Vellezerit që bashkëndajnë të njëjtin mutacion genik mund të paraqesin kushte klinike krejt të ndryshme. Veç asaj sëmundja ka të njëjtën ecuri në binjaket



mono-ovular. Sëmundja është e përcaktuar nga funksionimi anormal i një proteine të quajtur CFTR (Cystic fibrosis transmembrane regulator) e cila rregullon kalimin e klorit nëpërmjet membranës së qelizave epiteliale. Kjo proteinë kodefikohet nga një gjen mutacioni i të cilit nuk provokon defekte të sintezës ose madje as nuk pengon formimin e saj. Defekti i CFTR sjell pasojë të ndryshme që është e vështirë të interpretohen të veçuara, ka rregullime të disa sekrecioneve si djersja e pasur me kripë ose lëngjet e rrugëve të frymëmarrjes janë me të dendura ngaqë janë të varfëra me ujë si dhe anomali të tëmthit, gjë e cila është e shpeshtë. Për të përcaktuar fibrozën cistike është e nevojshme përcaktimi i trashigimisë me genin mutant në të dy prinderit (CFTR). Shfaqjet klinike në rreth 15% të rasteve mund të mbarten që nga lindja me një formë të rëndë bllokimi të zorrës (Ileusi mekanik) i cili duhet të nënshtrohet operacionit kirurgjikal në mjaft raste. Pjesën më të madhe të rasteve shfaqjet janë që në javët e para ose në muajt e parë të jetës me vonë në rritje, gjë e cila vjen nga përvetesimi i paktë i yndyrnave si pasojë e mungesës së lëngut të pankreasit. Fecet

jane të forta dhe femija nuk shton peshe. Në raste të tjera shenja e parë është infeksioni i përsëritur në rrugët e frymëmarrjes, kjo ngaqë është në përgjithësi në dekursin natyral të sëmundjes me simptoma pak a shumë të rënda. Për vendosjen e diagnozës fibroze cistike, nevojitet analizat e gjakut të të porsalindurit. Në pjesën më të madhe të vendeve të zhvilluara ka një program depistimi neonatal masiv, duke ju nënshtrohet testeve të thjeshta si tripsina imunoreaktive. Nëse rezultatet e para janë pozitive, neonati nënshtrohet provave specifike, si testi i djersës që premt për diagnozën specifike të fibrozës cistike. Në vijim bëhen analiza gjenetike për të kuptuar cili është mutacioni prezent i cili identifikohet në 85% të rasteve. Kryhen ekzaminime dhe në familje për të zbuluar portoret, testi i djersës kryhet në lëngjet biologjike duke përcaktuar sasinë e klorit që ndodhet aty. Pacientet me fibroze cistike tregojnë një përqendrim të rritur të klorit në djersë, test ky që vendos diagnozën në një pjesë të madhe të rasteve. Në raste kur testi është i dyshimtë, ekzaminimi përsëritet me vonë dhe disa here. Ekzistojnë dhe ekzaminime më të sofistikuar në qendra të specializuara në ratet

e dyshimta për ekzaminime gjenetike.

### Mjekimi ;

Nuk mund të flasim për një terapi zgjidhëse perfundimtare deri me sot që të mund të shërojnë sëmundjen. Ka kura të zgjatura, me enzima pankreatike dhe fizioterapeutike dhe kura të shpeshta ose të here pas hereshme me antibiotike, aerozole për zgjerimin e rrugëve të frymëmarrjes dhe pozicionime për drenazhim me të mirë, duhet të mjekohen nderlikimet si dëmtime të melcisë ose diabeti në mënyrë specifike sipas rastit konkret. Te sëmurët me fibroze cistike duhet të drejtohen në shumë qendra të specializuara sipas organeve të prekura, të cilat janë të ndryshme në mushkëri, melci, zorrë etj. Kura e parë duhet të drejtohet për normalizimin e tretjes dhe për parandalimin e dëmtimeve në mushkëri pra krahas enzimave pankreatike që duhet të jepet për kohe të gjata, duhet parandalohen shenjat e frymëmarrjes me programe fizioterapeutike për të lejuar nxjerrjen e mukosit dens që të mos grumbullohet apo të infektet duke kaluar në vijat e poshtme të frymëmarrjes. Aspekti digjestiv i kësaj sëmundje është gjithnjë me i lehtë për tu kontrolluar, ndërkohe që në formën pulmonare - prekje të mushkërive paraqitet me infeksione të përsëritura të frymëmarrjes në mënyrë kronike dhe procese inflamatorë të persistente dhe riacutizime të here pas hereshme. Më parë fibroza cistike ka qënë një sëmundje mortale, sot panorama e saj është përmirësuar në mënyrë thelbësore qoftë nga diagnostikimi i hershëm, perfeksionimi i trajtimit dhe kapja që fazat e lehta të sëmundjes.

Përgatiti

Dr. Med. **Ndue Nikaj**

## \*\*\* POEZI \*\*\* \*\* POEZI \*\*\* POEZI \*\*\* POEZI \*\*\* POEZI \*\*\* POEZI \*\*\* POEZI \*\*\* POEZI

### DHIMBJA NA BASHKON!

Dite e Marte  
Dite e mallkuar  
Në orët e natës  
Na ke lënduar

Solidariteti nga Bota mbare  
Lutje bën Papa në Vatikan  
Të ndihmojmë popullin shqiptar  
Nga fatkeqësia që ka pësuar

U lëkund Toka  
Si gjethja në peme  
Tridhjetë sekonda  
Me shume nuk qene

Në këmbë vëllezërit kosovar  
Pas tyre të gjithë me radhe  
Greke, turk, serb e italian  
Ballkani, Evropa dhe Amerika mbare

Populli i lemëritur  
Në rrugë ka dale  
Zotit i luten  
Tu qëndroi pranë

Ndihme ty me të dhëne  
Jete njerëzish ata shpëtuan  
Poshtë gërmadhëve aty ku ranë  
Shume ngelen e pak shpëtuan

Shqipëri halli te ka zënë  
Plage trupi të është bërë  
Nga tërmeti që ka rene  
Të gjithë u çuan në këmbë

Shqiptaret sot janë në zi  
Flamurin ulur e kane  
Problem patën pleq e fëmijë  
Festat e Nëntorit si me parë nuk janë

Gjithë populli shqiptar  
Me dhimbje janë bashkuar  
Lotët zemrën e lënduan  
Për viktimat (51), që tërmeti ka marre

Gjithkush lotin e ka provuar  
Kur të afërmit u janë larguar  
Por lotët ketë radhe  
Janë për kombin shqiptar

Para qiririt të ndezur  
Si familje ulur në gjunjë  
I lutem Zotit  
Të na ndihmoje më shumë

### DIELL MBI TRËNDAFILA

Raoul Follerau, 1925

“E pastaj që të kuptohemi, e dashura ime, nevojitet t’i flasim njëri-tjetrit?...  
Ëndrra ime është kjo: të shkojmë në të dy, të vrapojmë lehtë në fusha të gjelbërta.  
Pastaj të shohim, në heshtje, mrekullinë e ëmbël të mbrëmjes që zbret dhe ta sodisim mengadalë, të bashkojmë duart tona gjersa të mund të fluturojmë lart drejt Hyjit parfumi i ëmbël i zemrës sonë që lutet.  
Për një rreze që vdes, një trëndafil lulëzon.  
Të qahet, pastaj të buzëqeshim, e t’i buzëqeshim jetës me sy të lumtur, të mbështjellë me lotë”.

Përktheu: **Nikolin Sh. Lëmezhi**

**Përparim Sulo Hasani,**  
28 nëntor 2019







# I LINDUR PËR TË SFIDUAR DHE FITUAR

- BASHKËBISEDIM ME PËRFAQËSUESIN E AUTORIZUAR TË KOMPANISË  
"KOSOVO MANAGEMENT CONSULTING", KUSHTRIM KOZMAÇI -

Nuk më kishte rastisur më parë që të ndërmerrija një udhëtim për në Prishtinë enkas për një intervistë. Kjo ndodhi pak ditë më parë me insistimin e Përfaqësuesit të Autorizuar të Kompanisë "Kosovo Management Consulting", Kushtrim Kozmaçi. Pas njohjes dhe prezantimi krejt të rastësishëm në rrjetet sociale si pasojë e thirrjes që ai kishte bërë për kompaninë e tij, Kushtrimi insistoi që të shkoja e ta takoja personalisht në Prishtinë me qëllim që edhe intervista të dilte sa më origjinale.

Në raste të tilla kur më duhet jo rrallë që të bëj intervista në distancë, këtë e kam bërë me lehtësi sepse interneti të ofron këtë mundësi por me Kushtrimin duket se kjo nuk funksiononte. Udhëtimin vajtje-ardhje brenda ditës në Prishtinë nga Tirana e bëra me ditën e premte date 17 janar. Mbase coincidence, por bash në 552-vjetorin e vdekjes së Heroit tone Kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu...

I imët dhe elegant në paraqitjen e tij të jashtme mund të them me plot gojë se një gazetar e ka vështirë ta ndjekë Kushtrimin qoftë edhe ne prononcimin e tij për një intervistë. Kjo sepse edhe gjatë bisedës paraprake si dhe gjatë regjistrimit ai i përgjigjej telefonatave të panumërta që na ndërprisnin kohë pas kohe. Mbase këtu ka vend ajo thënia e hershme sipas së cilës në përgjithësi, të diplomuarit për shkencat ekzakte janë më të suksesshëm dhe me praktike në jetë se ato të shkencave shoqërore dhe të letrave...

Por nga ana tjetër, pavarësisht shpërndarjes dhe angazhimeve të tij të ngjeshur që reflektonte edhe në ato pak orë që ishim bashkë, intervista nuk më mori kohë sepse dukej se Kushtrimi kishte çdo përgjigje koncize në gojë dhe në këtë pikë nuk pata fare nevojë që t'ia bëja 2 herë të njëjtën pyetje.

**ARBEN LAGRETA\***

**Në fillim do të ishte me interes për lexuesin një resume e vogël e juaja. Kush është Kushtrim Kozmaçi?**

Kam lindur dhe i rritur në Prishtinë, jam 33 vjeç dhe i martuar nga viti 2018, me gruan e ëndrrave të mia.

Dikur punonim bashkë me gruan në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në Departamentin e Financave, ku unë vazhdoj të punoj tutje me një kontratë pa afat (akt emërim), si zyrtar i lartë për Buxhet dhe Financa, kurse grua ime me kontratë me shërbime të veçanta.

Në shkurt të vitit 2019, Zoti na bekoj



**Kushtrim Kozmaçi**

me një vajzë Hanën, ku gruaja ime si gjithmonë e përkushtuar në familje, u detyrua që t'i përkushtohet vajzës sonë duke u pajtuar edhe me fatin që do të mbetet pa punë.

Unë si burri i saj nganjëherë ndihesha fajtorë, për humbjen e punës së gruas. E tmerrshëm kjo ndjenjë...

Mendova gjatë e gjatë, dhe duke pas parasysh se gruaja ime ishte një studente e diplomuar me suksese të shkëlqyera në Universitetin e Prishtinës, një punëtore shumë e madhe dhe e zonja në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dikur, vendosa që të investoj dhe të hap një



biznes me emrin "Kosovo Management Consulting", me pronare gruan time.

Për ti ndihmuar rreth hapjes dhe të gjitha proceduarve u regjistrova si Përfaqësues i Autorizuar i Kompanisë me datë 9 dhjetor 2019. Kompania "Kosovo Management Consulting" e regjistruar nga data e lartpërmendur mendon të fillojë nga aktiviteti të shtunën tjetër datë 2 shkurt 2020.

**Ku do të konsistojë aktiviteti i "Kosovo Management Consulting"?**

Aktivitetet kryesorë të kësaj kompanie do të jenë këshillimet për biznes, këshillat e tjera për menaxhim si dhe aktivitetet e kontabilitetit, libër mbajtjes dhe auditivit si dhe këshillime tatimore.

**Por gjatë bisedës më përmendet edhe aktivitetet e tjera. Çfarë tjetër më konkretisht për lexuesin?**

Aktivitetet e tjera me të cilat do të veprojë kompania jonë janë:

-Aktivitetet tjera shërbyese në mbështetje të bizneseve, organizimi i konferencave dhe panireve afariste, aktivitetet mbështetëse arsimore, arsimit tjetër p.k.t, aktivitetet e përkthimit dhe interpretimit, aktivitetet e specializuara të dizajnit, aktivitetet e programimit kompjuterik, çeb portalet, teknologjia tjetër informative dhe aktivitetet shërbyese kompjuterike, aktivitetet e kombinuara shërbyese të administrimit të zyrave, aktivitetet e udhëheqjes së ndërmarrjeve dhe aktivitetet juridike.

**Le të vijmë tani në ditën që keni caktuar për çeljen zyrtare të "Kosovo Management Consulting" të shtunën datë 1 shkurt në Prishtinë. Ç'mund të na thoni në mënyrë paraprake për këtë ditë të shënuar për juve?**

Mendojmë dhe jemi duke punuar shumë në organizimin e Kampanjës së Kompanisë me rastin e hapjes dhe fillimit të aktiviteteve të saj. Konkretisht jemi në bisedime me shumë këngëtar/e të skenës së artë të muzikës shqiptare për të kënduar në eventin e kompanisë, gjithmonë duke investuar në marketingun e kompa-

Biletat e koncertit i cili do të vazhdoj pas kampanjës së kompanisë kemi menduar që të kenë çmimin 10 Euro. Mendojmë që 15 % nga fitimi total nga shitja e biletave t'i investojmë në artistët e përzgjedhur natën e eventit, duke ju ndihmuar në incizimin e albumit të tyre dhe të tjera kërkesa që i kanë të nevojshme dhe të domosdoshme.

Po ashtu atë natë do të promovohet edhe Shqiptari i cili jeton në gjermani Kristian Thaçi, me origjinë nga Kosova si formulist i Nivelit F4. Do të vazhdojmë ti ndihmojmë me 15% tjera të fitimeve nga biletat, duke e sponsorizuar për garat në F3.

Nuk do të jenë të mjaftueshëm këto mjete për të, por gjatë koncertit do të kërkojmë sponsorë të tjerë për djalosin e talentuar Kristian Thaçi, që ditët e fundit ishte në takim punë në Prishtinë me ne.

**Gjatë korrespondencës sonë të parë ju më keni folur edhe për një djalë të pamundur, i cilin do ta ndihmoni. Për çfarë është fjala?**

Po, është një djalë i ri, i cili ka lindur në karrocë sepse është me aftësi të kufizuara që njëzet vite e më tepër dhe mendojmë që ta ndihmojmë me 15 % të tjera nga fitimi i shitjeve të biletave. Pra jo drejtpërdrejtë me mjete, por duke e punësuar në kompaninë tonë me një pagë mesatare të Kosovës. Ky djalë quhet Erblin .... identitetin e të cilit nuk do ta zbuloj në tersi. Ai ka trokitur në derën tonë përmes rrjeteve sociale dhe ka kërkuar ndihmë duke kërkuar ta ndihmojmë që të shkoj në Gjermani për të punuar. Mendojmë mirë e mirë dhe në fund vendosëm që ikja e tij nuk ishte zgjidhje. Mendojmë se do ti ia dalim ta ndihmojmë dhe ta punësojmë në Kosovë konkretisht në Gjakovë në qytetin e lindjes së tij.

**Shumë interesant ky prezantim dhe në kaq pak kohë Kushtrim, unë ndjehem i sqaruar plotësisht. A keni gjë për të shtuar tani që jemi ballë për ballë?**

Unë u mendova t'ju pronocohem drejtpërdrejt sepse ju vlerësoj si gazetar në bazë të prezantimit tuaj dhe u mendova shpejt që t'ju jap këto të dhëna. Punë të mbarë dhe shpresojmë që do të nxjerrësh më të mirën nga vetja me historinë tuaj për Kompaninë "Kosovo Management Consulting" (KMC).

Bashkëbisedoi ARBEN LAGRETA, PRISHTINE, 17 JANAR 2020

\*Autori është Koordinator i Rajonit të Veriut dhe i Marrëdhënieve me Jashtë në Unionin e Gazetarëve Shqiptarë (UGSH).

## REDAKSIA

**Kryeredaktore: Suela Ndoja**

**Redaktorë: Luigj Shyti, Lazër Stani, Roza Pjetri, Prelë Milani, Lazër Kodra, Zef Nika, Zef Gjeta, Lulash Brigja, Kole Çardaku, Eilda Delija, Age Martini, Klodiana Serraj, Vilson Peshkaj, Marijan Ndershtiqaj, Arber Shytani, Zef Bari, Gjon Fierza e Ndue Ziçi.**

**Mundësoi Botimin:  
KUJTIM FUNIÇI**

